



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5817 Prot

Vlorë, më 25.03 2026

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë 31.03.2026.

### ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE  
PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën e martw, datë 31.03.2026, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhje e radhës e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4,ku pas ;

- 1.Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 10 - 30, datë 28.02.2026.( Dy shkresat e ardhura nga P.Q.Vlorë )
- 2.Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes të Këshillit të Bashkisë, për muajin Shkurt , datë 28.02.2026.

**Do të vazhdojmë me këtë rend dite:**

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin Shkurt 2026 ”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2026”.
3. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 23.12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2026”.
4. Projektvendim “Për miratimin e Buxhetit Faktik të vitit 2025(Buxheti i Kushtëzuar, i Pavarur dhe Specifik)” dhe Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025”.
5. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 98, datë 27.11.2025”Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2026”,të ndryshuar”.

6. Projektvendim “Për një shtesë në VKB Nr 46, datë 29.05.2024” Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi”.
7. Projektvendim “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit”.
8. Projektvendim “Për miratimin e zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga EKB në lagjen “Kushtrimi”, Rajoni Nr 5, Vlorë, miratimin e sistemit të pikëzimit , nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe, dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet/individët që do të përfitojnë nga ky program”.
9. Projektvendim “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinansim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
10. Projektvendim “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve përfitues të projektit “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, për vitin 2026”.
11. Projektvendim “Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimeve Nr 25, datë 28.03.2022 dhe Nr 57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë”.
12. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga dalja e lumit Vjosa, në datë 08.01.2026, në banesat e qytetarëve dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
13. Projektvendim “Për krijimin e Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit dhe Titujt e veçantë Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë”.
14. Të Ndryshme.

**Kryesia e Këshillit të Bashkisë**, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, datë 25.03.2026, **ora 13:00.**

**Komisionet e përhershme**, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

**Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike**, do të mbledhet ditën e hënë , datë 30.03.2026 , **ora 09:00.**

**Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet**, do të mbledhet ditën e hënë, datë 30.03.2026 , **ora 10:30.**

**Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit**, do të mbledhet ditën e hënë , datë 30.03.2026 , **ora 12:30.**

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5816, Prot.

Vlorë, më 25.03. 2026

**VENDIM**

**Nr 3, datë 25.03.2026**

**“MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E  
RADHËS” (Ora 13:00)**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 53, Neni 56, pika 2/a dhe, Rregulloren “Për Organizmin dhe Funkionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 58 dhe 59, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 25.03.2026,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 31.03.2025
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**

